

# RREGULLORJA E PUNËS TË SHOQATËS DARDANIA

---

## Kreu I

### Neni 1

#### Emri dhe Adresa

1. Shoqata mban emrin *Kosova-Belgje Dardania OJQ*
2. Adresa zyrtare e shoqatës është *Belgielaan 16, 8700 Tielt*, e cila ndodhet në rrethin juridik të Bryzhit. Adresa mund të ndryshohet me vendimin e kryesisë të shoqates kudo mbrenda ketij rrethi juridik.

### Neni 2

#### Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Shoqata ka për qëllim të organizojë, bashkëorganizojë apo promovojë aktivitete kulturore, sociale dhe sportive, pa pasur qëllim përfitime financiare.
2. Do të jetë edhe qendër informative për komunitetin shqiptarë të regjionit të Tieltit.
3. Si dhe do të ofrojë ndihmë morale dhe financiare në rast vdekje të ndonjë anëtari të shoqatës.
4. Shoqata ka të drejtë të organizojë çdo lloj aktiviteti që ndihmonë në realizimin e këtyre qëllimeve. Mund të zhvillojë edhe aktivitete me përfitime financiare me kusht që të mirat materiale të shfrytëzohen vetëm nga shoqata dhe për qëllimet e përmendura me lartë.
5. Shoqata është neutrale përballë çdo organizimi politikë.
6. Për secilin objektiv shoqata mund të formojë njësi te veçantë, të cilat do të merren me realizimin e objektivave të caktuara.

Për momentin janë të definuara këto departamente:

#### 6.1. Angazhim social (humanitar)

- 6.1.1. Ndhimja financiare për ceremonin mortore në rast vdekje të ndonjë anëtari të shoqatës
- 6.1.2. Shuma 3000 euro për kufomë
- 6.1.3. Të hollat do të dorëzohen përgjegjës të familjes, ose mund të transferohen në xhirrollogari sipas dëshirës së përgjegjës të familjes
- 6.1.4. Dorëzimin apo transferimin e ka për detyrë ta bëjë njëri prej anëtarve të kryesisë
- 6.1.5. Përgjegjësi i familjes në fjalë është i obliguar të nënshkruajë dëshmin për pranimin e të hollave, nëse ato dorëzohen para të gatshme. Nëse transferohen nëpërmjet bankës dëshmia merret në bankë
- 6.1.6. Përgjegjësi i familjes në fjalë është i obliguar që në afatin sa më të shkurtë të mundshum ta dorëzojë çertifikaten e vdekjes në kryesi të shoqatës

## **6.2. Sport**

- 6.2.1. Departmenti i sportit do të rexhistrohet në këshillin sportiv të komunës
- 6.2.2. Shoqata do të ndihmojë në zhvillimin e aktivitetit aktual në futboll, i cili zhvillohet çdo të Shtune prej orës 18 deri në ora 20 .
- 6.2.3. Sigurimi dhe pagesa e sallës do të bëhet në emër të shoqatës
- 6.2.4. Çdo pjesmarrës e bën pagesën njësoj sikurse deri më tani, grumbullimin e të hollave e bën personi i autorizuar
- 6.2.5. Të hollat e grumbulluara do të shfrytëzohen për sigurimin e lojëtarve në rast lëndimi gjatë lojës

## **6.3. Arsim**

- 6.3.1. Varësisht nga interesimi dhe numri i nxënësve, shoqata do të ndihmojë në organizimin e mësimit në gjuhën shqipe
  - 6.3.2. Do të ndihmojë në sigurimin e kuadrit, mjeteve mësimore dhe sallës për mbajtjen e mësimit
  - 6.3.3. Mësimi do të zhvillohet në bazë të **“Kurikules së shkollës shqipe të mësimit plotësues në diasporë (MASHT, 2007)”**
  - 6.3.4. Mësimi përfshin tri nivele
    - 6.3.4.1. Niveli i parë që përfshin klasat I-III
    - 6.3.4.2. Niveli i dytë që përfshin klasat IV-V
    - 6.3.4.3. Niveli i tretë që përfshin klasat VI-IX
  - 6.3.5. Dita e mbajtjes së mësimit mbetet të përcaktohet
    - 6.3.5.1. Propozim : çdo të diele prej orës 10 deri në ora 14
7. Shoqata ka të drejtë të zhvillojë aktivitete ekonomike me kusht që të ardhurat nga ky aktivitet të shfrytëzohen për qëllimet e shoqatës

## **Neni 3 Kohëzgjatja**

- 1. Kohëzgjatja e shoqates është për kohë të pacaktuar dhe mund të shpërndalet në çdo kohë.

**Kreu II**  
**Neni 4**  
**Organet përgjegjëse**

1. Shoqata përbëhet prej kryesisë
  - 1.1. Numri i anëtarëve të kryesisë nuk është i kufizuar, por kryesia duhet të përbëhet prej së paku tre anëtarëve . Themeluesit e shoqatës do të jenë anëtarët e parë të kryesisë.
2. Këshillin e shoqatës si dhe
3. Anëtarëve të tjerë
4. Të gjithë anëtarët e shoqatës të moshës madhore kanë të drejtën e votimit në mbledhjen e shoqatës.

**Neni 5**  
**Mbledhja e kuvendit të shoqatës**

**Përgjegjësia dhe Kompetencat**

1. Mbledhja e kuvendit të shoqatës mbahet me të gjithë anëtarët e moshës madhore. Secili anëtar i shoqatës ka të drejtën e votës. Një anëtar i shoqatës mund të përfaqësoj një anëtar tjetër të shoqatës nëse ka autorizimin me shkrim (mund të përfaqësoj vetëm një anëtar) .
2. Me vendimin e mbledhjes të kuvendit mund të ndryshohen:
  - 2.1. Statuti i shoqatës,
  - 2.2. Pranimi apo largimi i anëtarit të kryesisë.
  - 2.3. Emërimi apo shkarkimi nga organet udhëheqëse.
  - 2.4. Miratimi i buxhetit dhe i shpenzimeve.
  - 2.5. Shpërndarja e shoqatës.
3. Shpërndarja e shoqatës duhet të bëhet në të gjitha rastet ku ligji e kërkon një gjë të tillë.
4. Në tre mujorin e parë të vitit kalendarik duhet të organizohet mbledhja e kuvendit të shoqatës për miratimin e shpenzimeve të vitit të kaluar si dhe miratimin e buxhetit të vitit aktual.
5. Mbledhja e kuvendit mund të organizohet me iniciativën e udhëheqësisë apo me kërkesën e një të pestës të anëtarëve të përgjithshëm të shoqatës.
6. Së paku tetë ditë para mbajtjes së kuvendit, kryesia I dërgon ftesë çdo anëtari të shoqatës me shkrim apo e-mail. Ftesa duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin dhe datën e mbajtjes së kuvendit. Çdo anëtar ka të drejtë të propozojë ndonjë pikë të re në rend dite, me kusht që kërkesa ti dërgohet kryesisë me shkrim apo me e-mail.
7. Mbledhjen e udhëheqë ndonjëri prej anëtarëve të kryesisë
8. Në mbledhjen e kuvendit mund të mirren vendime vetëm për qështjet të përcatuara në rendin e ditës.

9. Vendimet merren me shumicë vote
10. Në mbledhjen e kuvendit duhet të jenë të pranishëm së paku gjysma e anëtarve të kryesisë
11. Ndryshimi i statusit mund të bëhet vetëm konform ligjit.
12. Në rast se votimi është i barabartë votimi i udhëheqësit të mbledhjes është vendimtar.
13. Votimi duhet të jetë i fshehtë nëse për këte kërkojnë dy të tretat e anëtarve të kryesisë.
14. Për çdo mbledhje duhet të mbahet procesverballi, i cili ruhet në selinë e shoqatës

## **Neni 6**

### **Këshilli i të shoqatës Përgjegjësia dhe Kompetencat**

1. Këshilli i shoqatës zgjidhet/shkarkohet në mbledhjen e kuvendit. Këshilli i shoqates numerikisht është më i vogël se anëtarësia e përgjithshme.
2. Ushtrimi i funksioneve udhëheqëse është pa pagesë
3. Funksionet udhëqse mund ti ushtrojnë vetëm anëtarët e kryesië dhe të këshillit.
4. Kohëzgjatja e mandatit në funksione udhëheqëse është për kohë të caktuar dy vjeqare.
5. Dorëheqja nga funksioni udhëheqës mund të bëhet duke informuar kryesinë me shkrim apo e-mail.
6. Shkarkimi mund të behet vetëm në mbledhjen e kuvendit me tri të katërtat e votave të të pranishmëve në mbledhje.
7. Në rast të ndërprerjes të ndonjë mandati udhëheqës pa marrë parasysh arsyet, zëvendësimi bëhet duke zgjedhur një mandator të ri. Zgjidhja bëhet në mbledhjen e kuvendit të shoqates. Deri në zgjidhjen e mandatarit të ri detyrën duhet ta kryejnë anëtarët e mbetur të udhëheqësis.
8. Kryesia e shoqatës përfaqëson shoqatën në të gjitha çështjet juridike apo shoqërore , për këtë nuk ka nevojë të merret pëlqimi nga mbledhja e kuvendit. Vepron si paditës apo i paditur në të gjitha proceset gjyqësore dhe vendos për veprimet që duhet bërë në këtë drejtim.

## **Kreu III**

### **Neni 4**

#### **Anëtarësimi në Shoqatë**

1. Kusht për anëtarësim është pranimi i statusit të shoqates. Kandidati duhet të parashtrojë kërkesen për anëtarësim te këshilli udhëheqës. Këkesa mund të behet përmes postes apo e-mailit.
2. Kërkesa për anëtarësim shqyrtohet në mbledhjen e përgjithshme të shoqates dhe vendoset me dy të tretat e anëtarve pranishëm në mbledhje.

## **Neni 5**

### **Largimi apo Shkarkimi nga Shoqata**

1. Anëtarshimi është për kohë të pacaktuar.
2. Mund të ndërpritet në çdo moment me vetëiniciativë të anëtarit.
3. Ndëpritet automatikisht në rast vdekjes së anëtarit.
4. Anëtarit mund të përjashtohet nga shoqata nëse ai nuk i përmbahet rregullorës së punës apo nuk e bën pagesën anëtarshisë.
5. Anëtarit i përjashtuar duhet t'i dorëzohet shoqatës të gjitha gjërat të cilat i përkasin shoqatës dhe i ka në posedim si dhe duhet t'i kryejë të gjitha borxhet që i ka ndaj shoqatës.
6. Shoqata duhet të ketë regjistrin e anëtarëve të kryesisë si dhe anëtarshisë së gjerë. Në këtë regjister duhet të shënohen këto të dhëna : emri, mbiemri , adresa , data e anëtarshimit, data e largimit apo përjashtimit të anëtarëve të shoqatës.

## **Neni 6**

### **Pagesa e Anëtarshisë**

1. Pagesa e anëtarshisë bëhet një herë në vit dhe duhet të paguhet para 1 janarit
2. Pagesën duhet ta kryej secili anëtar, çmimi është:
  - 2.1. Deri në moshën 18 vjeçare 15 euro
  - 2.2. Mbi moshën 18 vjeçare 30 euro
3. Pagesa bëhet vetëm nëpërmjet transferimit të të hollave në xhironlogarin e shoqatës

## **Kreu IV**

### **Kontabiliteti**

1. Balanci financiar bëhet për çdo vitë dhe përfshin perioden kohore prej 1 janari deri me 31 dhjetorë.
2. Në fillim të çdo viti kalendarik në mbledhjen e kuvendit kryesia duhet të bëjë:
  - 2.1. Raportimin për punën e kryer në vitin paraprak
  - 2.2. Arsyetimin e shpenzimeve dhe paraqitjen e dëshmimeve lidhur me shpenzimet
  - 2.3. Raportimin e të hyrave dhe paraqitjen e dëshmimeve lidhur me burimin e të ardhurave
  - 2.4. Propozimin e buxhetit për vitin aktual

## **Kreu V**

### **Shpërndarja**

1. Shpërndarja e shoqatës mund të bëhet
  - 1.1. Nëse ligji e përcakton një gjë të tillë
  - 1.2. Nëse kuvendi vendos
2. Të mirat materiale në posedim të shoqatës në momentin shpërndarjes duhet të përdoren për:
  - 2.1. Shlyerjen e borgjeve
  - 2.2. Kryerjen e të gjitha obligimeve të mbetura
  - 2.3. Pjesa e mbetur duhet ti dhurohet ndonjë shoqate që zhvillon aktivitet të ngjajshëm.

Anëtarët kryesisë:

- ILMI Maxhuni
- NEBIH Mehulli
- BEHAR Beka
- SHPEND Prekazi
- FATMIR Latifi